



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	19.02.2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	INDEP- Fatbardha Restelica
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga INDEP me përfaqësuese Fatbardha Restelica e cila kërkon shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Zahir Pajaziti” me datën 15 Mars 2021.

Qëllimi i aktivitetit është shënimi i ditës Botërore për Mbrojtjen e Konsumatorit ku qëllimi kryesor i projektit është që institucionet qendrore të prioritetizojnë mbrojtjen e konsumatorit në sektorët e zhvillimit.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike me datën 15 Mars 2021 në Sheshin “Zahir Pajaziti”.

Kushtet e pëlqimit:

- të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ;
- varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandeemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.